



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2021:019608

Datë: 23.03.2024

Numri i dokumentit: 05494688

C.nr.168/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Komuna e Prizrenit-Drejtoria e B.Zh.R. me seli në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, kundër të paditurve: L.K. nga fshati .... Komuna e Gjakovës, L.Q.1., L.Q.2., dhe K.D. që të tre nga fshati .... Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av. M.Sh. nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 1,000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të të autorizuarës së paditëses, më datë 15.03.2024 mori, ndërsa më datë 22.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Komuna e Prizrenit-Drejtoria e B.Zh.R. me seli në Prizren.

II. DETYROHEN të paditurit: L.K., L.Q.1., L.Q.2., dhe K.D., që në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar për shkak të gjuetisë së kundërligjshme të datës 15.09.2019, në mënyrë solidarë, paditëses t'ia paguajnë shumën prej 1,000.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësja Komuna e Prizrenit-Drejtorija e B.Zh.R. me seli në Prizren, përmes të autorizuarve të saj pranë kësaj gjykate me datë 03.02.2021, ka parashtruar padi për kompensim dëmi material kundër të paditurve L.K., nga fshati ....., komuna e Gjakovës, L.Q.1., L.Q.2., dhe K.D. që të tre nga fshati ..... komuna e Gjakovës, me objekt të kontestit kompensim dëmi, vlera e kontestit 1,000.00 euro.

Në padi, është theksuar se të paditurit me datë 15.09.2019, në kundërshtim me ligjin për gjueti dhe pa leje të shoqatës së gjuetarëve kanë gjuajtur kafshë të egra në territorin dhe kohën kur gjuetia është e ndaluar, në të cilën kanë vrarë një derr të egër, të cilin e kanë ngarkuar në bagazhin e veturës, gjë që është vërtetuar gjatë kontrollimit të asaj zone nga ana e zyrtarëve policor dhe inspektoratit të Agjencisë Pyjore të Kosovës. Si rezultat i kësaj, me aktgjykimi penal të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1415/2019 të datës 09.03.2020, i cili është bërë i plotfuqishëm me datë 25.06.2020 të paditurit janë shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale gjuetia e kundërligjshme. Në bazë të Udhëzimit Administrativ 12/2009, për dëmet nga kafshët e egra dhe në kafshët e egra i datës 19.08.2009,

neni 16 par.8 pika a, në të cilin thuhet “për dëmin që shkaktohet nga personat fizik dhe juridik në kafshët e egra në vendgjueti në kundërshtim me Ligjin e Gjuetisë “derri, dosa dhe të vegjlit një dhe dy vjeçar” vlera e dëmit është në shumë prej 1,000.00 euro. Bazuar në të thënat më lartë, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe t’i obligojë të paditurit që të kompensojnë dëmin në shumën prej 1,000.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata me aktvendimin për përgjigje në padi të datës 05.03.2021, ia ka dërguar të paditurve padinë me prova, duke i detyruar të paditurit që brenda afatit prej 15 ditësh nga pranimi i tij të paraqesin përgjigje në padinë e palës paditëse. Të paditurit me datë 02.03.2021, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e kanë kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses dhe kanë kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Ka shtuar se të paditurit në procedurë penale janë gjykuar për rastin konkret në të cilën kanë aktgjykim të plotfuqishëm, ku janë dënuar me gjobë, të cilin dënim e kanë paguar në tërësi. Andaj, duke pasur parasysh se të paditurit nuk janë në marrëdhënie pune dhe kërkesa e kërkuar nga paditësja është shumë e lartë, kanë kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta hedh në mungesë të bazës juridike.

E autorizuar e paditëses gjatë shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar, se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Duke shtuar se pas administrimit të provave është e qartë se të paditurit, paditëses i kanë shkaktuar dëm në vlerë prej 1,000 euro, e kjo vërehet edhe me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1415/19, ku të paditurit janë shpallur fajtor. Kanë kërkuar nga gjykata që të aprovet në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses, ashtu që të detyrohen të paditurit që në mënyrë solidare paditëses t’ia kompensojnë dëmin në shumë prej 1,000 euro.

Shqyrtimin kryesor, gjykata e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur, në përputhje me nenin 423 par. 4 i Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), pasi që e njëjta është ftuar rregullisht, por që mungesën nuk e ka arsyetuar.

#### Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes gjykata ka administruar provat si në vijim: Procesverbalin e datës 16.09.2019, i Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, P.nr.1415/19 të datës 09.03.2020, i plotfuqishëm me datë 25.06.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

- kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar.

Nga leximi i Procesverbalit të datës 16.09.2019, i Agjencisë Pyjore të Kosovës, gjykata ka vërtetuar faktin se Inspektorati Qendror i pyjeve nga Agjencia Pyjore e Kosovës, kanë kryer inspektimin në DBZHR –Prizren me datë 16.09.2019 në ora 10:00, në të cilin inspektim kanë qenë të pranishëm edhe Policia e Kosovës-Stacioni “Alfa” në Prizren, dhe kanë konstatuar se këtu të paditurit në fshatin Has, Komuna e Prizrenit, kanë bërë gjueti ilegale dhe kanë vrarë një derr të egër të cilin e kanë ngarkuar në automjetin e të dyshuarit, përkatësisht të paditurve.

Nga leximi i aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, P.nr.1415/19 të datës 16.09.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se të paditurit janë shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale në bashkëkryerje gjuetia e kundërligjshme nga neni 350 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ku të akuzuarit vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë se kanë kryer veprat penale si në aktakuzë, përkatësisht kanë mbajtur në pronësi armë (të specifikuara si në aktgjykim) dhe pa leje të shoqatës së gjahtarëve kanë gjuajtur kafshë të egra në territorin dhe kohën kur gjuetia është e ndaluar, të pandehurit hasen nga policia dhe gjatë kontrollit iu gjeten armë të gjuetisë dhe një derr i egër i vrarë, të cilin e kishin ngarkuar në bagazhin e veturës, dhe për këtë iu është shqiptuar dënim me gjobë, ndërsa e dëmtuara këtu paditësja, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridik civil.

### Baza ligjore

Me nenin 136 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se: “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në bazë të kësaj dispozite pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Në nenin 140 të po këtij ligji parashihet se: ”Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”, e në çështjen kontestuese të paditurit nuk i kanë ofruar gjykatës prova që do të provonin se dëmi ndaj paditëses është shkaktuar pa fajin e tyre.

Me nenin 190 të LMD-së është rregulluar përgjegjësia e disa personave për të njëjtin dëm (përgjegjësia solidare), ku në paragrafin 1 është përcaktuar, “Për dëmin të cilin disa persona e kanë shkaktuar bashkërisht, përgjigjen të gjithë pjesëmarrësit solidarisht”, ndërkaq në paragrafin 4 të po këtij neni është përcaktuar, “Kur nuk ka dyshim se dëmin e ka shkaktuar ndonjë nga dy ose nga më tepër persona të caktuar, të cilët në ndonjë mënyrë janë të ndërlidhur midis tyre, ndërsa nuk mund të përcaktohet se cili prej tyre e ka shkaktuar dëmin, këta persona përgjigjen solidarisht”.

Gjithashtu me nenin 14 të LPK-së është paraparë se: “Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën i pandehuri është shpallur fajtor”, e që në çështjen konkrete ekziston aktgjykim i formës së prerë që ka shpallur fajtor të paditurit, të cilët përmes veprës penale i kanë shkaktuar dëm material paditëses.

Sa i përket lartësisë së dëmit gjykata është bazuar në nenin 16 par.8 pika a), të Udhëzimit administrativ Nr.12/2009, për dëmet nga kafshët e egra dhe në kafshë të egra, i cili ka përcaktuar, “Lista e vlerësimit për dëmin e shkaktuar nga personat fizik e juridik në kafshë të egra dhe në vendgjueti, në kundërshtim me Ligjin e Gjuetisë dhe sipas këtij udhëzimi administrativ është si në vijim:, 8.Derri i egër: a)derri, dosa dhe të vegjlit një e dy vjeçar 1,000.00 euro”.

### Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar në ligj dhe fakte. Gjykata ka vërtetuar se të paditurit janë përgjegjës për kompensimin e dëmit material ndaj paditëses, konform përgjegjësisë në bazë të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të cekur si më lartë, pasi që të njëjtit i

kanë shkaktuar dëmin material paditëses, duke shkaktuar dëm në kafshët e egra dhe vendgjueti, në kohën kur gjuetia nuk është e lejuar, dhe pa marrë lejen nga organet kompetente, fakt ky i cili është vërtetuar nga provat e proceduara në këtë çështje kontestimore.

Më konkretisht, gjykata ka ardhur në përfundim se të paditurit janë përgjegjës për kompensimin e dëmit ndaj paditëses, bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, me numër P.nr.1415/19 të datës 09.03.2020, përmes të cilit të paditurit janë shpallur fajtor për veprën penale në bashkëkryerje gjuetia e kundërligjshme, dhe se të njëjtit në mënyrë vullnetare e kanë pranuar fajësinë. Pra në kuptim të nenit 14 të LPK-së, baza juridike e kërkesëpadisë është vërtetuar përmes aktgjykimit të theksuar si më lartë.

Në anën tjetër, sa i përket lartësisë së dëmit të shkaktuar nga ana e të paditurve ndaj paditëses, gjykata këtë pjesë e ka vërtetuar nga procesverbali i hartuar nga Agjencisë Pyjore e Kosovës, respektivisht në përputhje me nenin 16 par. 8 pika a) e Udhëzimit administrativ nr.12/2009, për dëmin nga kafshët e egra dhe në kafshët e egra. Kjo pasi që në dispozitën ligjore të theksuar më lartë, në mënyrë specifike dhe konkrete është përcaktuar dënimi apo gjoba që do t'i shqiptohet personave që cenojnë apo veprojnë në kundërshtim me dispozitën ligjore të lartcekur.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimin e të paditurve dhënë në përgjigje në padi, që të njëjtit nuk janë në marrëdhënie pune dhe se vlera e kërkesës së paditëses është tepër e lartë, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është tërësisht i pabazuar dhe i mungon justifikimi juridik. Në të vërtetë, lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të specifikuar më lartë dhe bazuar në provat e administruara. Ndërsa, lidhur me faktin se të paditurit nuk janë në marrëdhënie pune, gjykata vlerëson se kjo çështje nuk shqyrtohet në këtë çështje juridike, aq më tepër që të njëjtit në asnjë fazë të procedurës nuk kanë paraqitur ndonjë provë me të cilën do të provoheshin pretendimet e tyre.

Andaj, gjykata ua fali besimin provave të elaboruara më lartë dhe vërtetoi faktin se të paditurit, kanë detyrim solidar, që paditëses t'ia paguajnë shumën prej 1,000.00 euro, në emër të dëmit material.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale, gjykata e mori konform nenit 450 dhe 463 par. 2, pasi që pala e paditur përkundër faktit se e ka fituar kontestin, nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.168/2021, më datë 22.03.2024

Gjyqtari  
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.